



► MINISTRI I JEP CMINI "AMBASADOR I KOMBIT" SUPERMARRËSIT DHE FILANTROPI T SHQIPTAR Z. LAZIM DESTANI



► GJATË TAKIMIT ME PËRFAQËSUES TË KOMUNITETIT SHQIPTARË NË MAL TË ZI Z. NIK GJELOSHIAJ, Z. NIKOLLE CAMAJ, Z. FADIL KAJOSHIAJ



► MINISTRI I SHTETIT PËR DIASPORËN TAKON PËRFAQËSUES TË BIZNESIT SHQIPTARË NË EUROPE DHE SHBA

NEWSLETTER E DIASPORËS



AGJENCIA
KOMBËTARE E
DIASPORËS



FONDI SHQIPTAR
PËR ZHVILLIMIN E
DIASPORËS



QENDRA E
BOTIMEVE PËR
DIASPORËN

PËRFAQËSIMI DHE NIXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDRËVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NIXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISE DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

Për herë të parë ndahen vlerësimet "Ambasador i Kombit"

Samiti i Dytë i Diasporës u mbyll mbrëmjen e djeshme me ceremoninë e dhënies për herë të parë të çmimit "Ambasador i Kombit", disa prej aktivistëve më të dedikuar ndaj komunitetit shqiptarë në botë. Të integruar në vendin ku jetojnë, por po aq të dedikuar ndaj ruajtjes së vendit të origjinës, gjuhës, kulturës dhe traditës shqiptare. Janë këta individë, puna e vazhdueshme e të cilëve bën që të mos harrohet Shqipëria në komunitetet ku jetojnë, e sidomos të kultivohet të brezat dytë dhe të tretë të fëmijëve të familjeve shqiptare në botë.

Një vlerësim të veçantë gjatë kësaj mbrëmjeje morën edhe mësuesit shqiptarë në Diasporë, pasi janë ata më së shumti që punojnë me fëmijët për ruajtjen e gjuhës shqipe. Vetëm mësuesit që do të jenë pjesë e regjistrimit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave do të kenë të drejtën të japin mesimin e gjuhës shqipe. Nga ana tjetër edhe nxënësit do të pajisen me një certifikatë në përfundim të klasës së gjuhës shqipe. Kjo nisim e ministrit të Shtetit për Diasporën është hapi i radhës në procesin e unifikimit të mësimit të gjuhës shqipe në Diasporë.



Fjala e plotë e ministrit mbajtur në ceremoninë e inaugurimit të memorialit të Skënderbeut, në Lezhë

Të dashur vëllezër dhe motra,

Kemi ardhur sot këtu së bashku me Presidentin e Republikës dhe me përfaqësues të shumtë të komuniteteve shqiptare në botë, nga Samiti i Diasporës që zhvilluam dje. Nuk është e rastit që Samiti i Diasporës e bashkëlidhi veten me këtë ngjarje kaq të veçantë siç është përvjetori i Kuvendit të Lezhës. Këtu filloi shqiptaria, këtu filloi Besëlidhja, këtu ne kuptuam dhe pohuam veten, këtu është testamenti.

Prandaj pa shumë fjalë kemi ardhur të nderojmë këtë ngjarje të jashtëzakonshme dhe të marrim prej saj, më shumë sesa ta përkujtojmë atë mesazh të madh, që Kuvendi i Lezhës i ka treguar dhe vazhdon ti tregojë, e do ti tregojë brezave që do të vijnë së çfarë janë në gjendje të bëjnë shqiptarët kur ata e ndajnë mendjen të bëhen bashkë.

Jemi sot këtu me shqiptarë, që nga Australia deri në Alaskë, nga Gjermania, nga SHBA, por më të veçantë janë ata, Arbëreshët. Me këtë rast më lejoni t'ju falënderoj për këtë pritje të veçantë, në veçanti të zotit e shtëpisë, kryetarit e Bashkisë, të gjithë autoritete e Lezhës dhe të gjithë vëllezërit dhe motrat e Lezhës, duke ju ftuar të gjithëve që ta kthejmë këtë datë në një ngjarje të përvitshme, ku të gjithë shqiptarët kanë arsye të vijnë këtu në Lezhë, për të përkujtuar dhe jo vetëm, por për të pohuar, ashtu sikurse thashë pak më parë, edhe vetveten.

Ju falënderim.



Miratohet krijimi i regjistrimit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe dhe certifikata për nxënësit në Diasporë



Këshilli i Ministrave ka miratur propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën për krijimin e regjistrimit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe në bazë të të cilit ministria përgjegjëse për arsimin krijon regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë. Ky regjistër do të përmbajë listën e mësuesve të cilët kanë të drejtë të japin mesim për programin e gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë. Gjithashtu aty do të pasqyrohen të dhënat e mësuesve në Diasporë të cilat do të bëhen pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga ana e tyre, në ministrinë përgjegjëse.

Në bazë të marrëveshjes "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë", datë 23.03.2015 ministria përgjegjëse për arsimin gjithashtu do të përgatisë certifikatën për nxënësit që përfundojnë programin e mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në Diasporë.

Vendimin e plotë për krijimin e regjistrimit të mësuesve të gjuhës shqipe dhe certifikatën për nxënësit mund ta lexoni në linkun e mëposhtëm:
<https://diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2019/03/VKM-REGJISTRIMI-MESUESEVE-NE-DIASPORE.pdf>

Ministri i Shtetit për Diasporën duke akorduar tre çmimet "Ambasador i Kombit" në Pallatin e Kongreseve

